



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

# Raport Vjetor

Janar – Dhjetor 2015

---

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP

Prishtinë, Mars 2016

Rruga "Migjeni" nr.21 Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati -I-, 10000 Prishtinë

[info@pzap-ks.org](mailto:info@pzap-ks.org), [www.pzap-ks.org](http://www.pzap-ks.org) 038/211-242

## Përmbajtja

Lista e shkurtesave .....	3
1. RRETH PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP) .....	4
1.1 Pjesa e Përgjithshme .....	4
2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT .....	5
2.1 Përbërja e PZAP-it .....	6
2.2 Funksonet, përgjegjësit dhe përbërja e Sekretariatit të PZAP-it .....	6
3. ORGANOGRAMI I PZAP-it.....	8
4. AKTIVITETET E PZAP-IT DHE të SEKRETARIATIT .....	9
4.1 Mbledhjet e Panelit dhe Çështjet e Vendosura.....	9
5. KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-IT .....	10
6. KOMISIONET E PËRHERSHME TË SEKRETARIATIT .....	11
6.1 Komisionet e përkohshme të sekretariatit të PZAP-it.....	12
7. AKTIVITETET E PZAP-IT PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS.....	12
8. PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2015 .....	13
8.1 Pjesëmarrja e anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita, trajnime dhe punëtori në vend dhe jashtë vendit.....	14
8.2 Vizita në Republikën e Shqipërisë .....	15
9. AKTIVITETET LIDHUR ME ÇËSHTJET E PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT	15
10. AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-IT .....	16
11. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME .....	17
11.1 Aktivitetet e buxhetit dhe financave.....	17
11.2 Aktivitetet për koordinimin e përkthimit të dokumenteve të PZAP-it.....	18
11.3 Aktivitetet e teknologjisë informative dhe logjistikës.....	19
11.4 Aktivitetet e zyrës së transportit.....	20
12. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT LIGJOR .....	20

13.	AKTIVITETET LIDHUR ME PËRMBARIMIN E VENDIMEVE TË PZAP-it LIDHUR ME GJOBAT E SHQIPTUARA NDAJ SUBJEKTEVE POLITIKE.....	21
14.	BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR (KQZ).....	22
15.	BASHKËPUNIM ME ORGANIZATEN PËR SIGURI DHE BASHKEPUNIM EUROPIAN - OSBE .....	23
16.	BASHKËPUNIM ME FONDIN NDERKOMBETAR PËR SISTEME ZGJEDHORE - IFES	24
17.	RAPORTI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE VJETORE PËR VITIN FISKAL-2015.....	25
17.1	Ndarjet Buxhetore .....	25
18.	BUXHETI I APROVUAR PËR VITIN 2015.....	26
18.1	Struktura e buxhetit për vitin 2015.....	27
19.	BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2015 .....	28
20.	PJESA PËRMBYLLËSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE.....	31
21.	TË HYRAT E PZAP-IT .....	32
22.	BASHKËPUNIMI I PZAP-it ME ZYREN E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – ZAP.....	35
23.	MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI .....	36

## **Lista e shkurtesave**

**DASHC** – Departamenti i Administratës së Shërbimit Civil

**IFES** – Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore

**KGJK** – Këshilli Gjyqësor i Kosovës

**KP** – Kandidat i Pavarur

**KPK** – Këshilli Prokurorial i Kosovës

**KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

**KRPP** – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik

**LZL** – Ligji për Zgjedhjet Lokale

**LZP** – Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme

**MAP** – Ministria e Administratës Publike

**MF** - Ministria e Financave

**NJQH** - Njesia Qendore Harmonizuese

**OSBE** – Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian

**PK** – Policia e Kosoves

**PZAP** – Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

**QNR** – Qendra për Numrimin e Rezultateve

**SIMBNJ** – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerezore – MAP

**SIMFK** – Sistemi Informativ për Menaxhmin e Financave të Kosovës

**SIMR** – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Rasteve

**SP**- Subjekete Politike

**SPZAP** – Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

**ZAP** - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

**ZRPPC** - Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim

# 1. RRETH PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)

## 1.1 Pjesa e Përgjithshme

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), është institucion i përhershëm dhe i pavarur kompetent për të vendosur në lidhje me ankesat dhe apelet që parashtrohen në PZAP nga palët e interesuara e që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor siç është përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), Rregullat Zgjedhore si dhe Rregullat e PZAP-it.

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe ligjeve tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës siguron trajtim të barabart dhe gjithëpërfshirës për të gjitha palët e involvuara në procesin zgjedhor, pavarësisht përkatësisë së tyre partiake, etnike, gjinore, fetare etj.

PZAP-i, ushtron funksionet dhe përgjegjësit e tij të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-256 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP) nenit 115 dhe dispozitave tjera të këtij ligji si dhe Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (Ligjinr. 03 /L-072).

Gjatë vitit 2015 në Republikën e Kosovës është organizuar një Proces Zgjedhor i Jashtëzakonshëm. Me datën 18 janar 2015 janë mbajtur Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Graçanices. Për këtë proces zgjedhor subjektet politike nuk kanë dorëzuar as një ankesë në PZAP, respektivisht PZAP-i nuk ka pranuar ankesa fare për këtë proces zgjedhor.

Edhe pse gjatë këtij viti nuk ka pasur procese tjera zgjedhore, PZAP-i, ka organizuar dhe zhvilluar aktivitete që kanë pasur për qëllim hartimin e legjislacionit sekondar (rregullave të brendshme), ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerezore dhe të teknologjisë informative të cilat do ta ndihmojnë dhe lehtësojnë funksionimin e PZAP-it në proceset e ardhshme zgjedhore dhe jo zgjedhore. Aktivitete me të rëndësishme kanë qenë:

- Hartimi i tri Rregullave të brendshme të PZAP-it,
- Finalizimi i Sistemit Informativ të Menaxhimit të Lëndeve për gjatë proceseve zgjedhore, fillimi i përgatitjes së Planifikimit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019.
- Pjesëmarrja në trajnime ku janë trajtuar tema me rëndësi për stafin e PZAP-it.
- Organizimi i disa punëtorive nga PZAP-i, OSBE-ja dhe IFES-i për stafin e PZAP-it.
- Pjesëmarrja e stafit të PZAP-it në vëzhgimin e zgjedhjeve në Shqipëri.

Të gjitha këto organizime kane pasur për qëllim ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të administratës së sekretariatit të PZAP-it, respektivisht ngritjes së performancës së institucionit të PZAP-it në përgjithësi.

## **2. STRUKTURA ORGANIZATIVE DHE BURIMET NJERËZORE TË PZAP-IT**

Struktura organizative e brendshme e PZAP-it, është e rregulluar në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-256, për Ndryshimin dhe Plotësimine Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, me të cilat përcaktohet funksionimi dhe përgjegjësia institucionale.

Struktura organizative e Institucionit të PZAP-it, përbëhet nga Anëtarët e Panelit si trup vendimarrëse profesionale dhe nga Sekretariati i tij i cili mbështet punën e PZAP-it në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me LZP.

PZAP-i, përbëhet prej 10 anëtarëve përfshirë Kryesuesen të cilët emërohen nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës me mandat katër (4) vjeçar dhe janë gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe Gjykatave Themelore të Kosovës.

Sekretariati i PZAP-it, përbëhet nga zyra e kryesuesit të sekretariatit me kryesuesin dhe asistenten ekzekutive, Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, i cili përbëhet prej 4 nëpunësve civil përfshirë drejtorin e departamentit, Departamentin Ligjore i cili perbehet prej 4 nepunesve civil, drejtori i departamentit bashke me tre zyrtarë të lartë ligjor.

Në kuadër të bazës ligjore siç përcaktohet me Ligjin Nr. 03/L-56, për Ndryshimin dhe Plotësimine Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe kompetencave që parashihen, Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës me vendimin Agj.nr. 410/2014 të datës 31.10.2014, ka emëruar Kryesuesen e Panelit dhe 4 anëtarë të ri si dhe ka riemëruar 4 anëtarë të PZAP-it edhe për një mandat katër vjeçar, si më poshtë:

1. Nazmije Ibrahim, Gjyqtare e Gjykatës Supreme të Kosovës, Kryesuese e PZAP- it;
2. Muhamet Rexha, Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit – Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
3. Hasan Shala, Gjyqtarë i Gjykatës së Apelit-Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
4. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore-Prizren, anëtarë (riemëruar);
5. Nehat Idrizi, Gjyqtarë i Gjykatës Themelore-Prishtinë, anëtarë (riemëruar);
6. Zyhdi Haziri, Kryetar i Gjykatës Themelore-Gjilan, anëtarë;
7. Fejzullah Rexhepi, Gjyqtarë i Gjykatës Themelore – Ferizaj, anëtarë;
8. Afijete Sada, Gjyqtarë e Gjykatës Themelore-Gjakovë, anëtare dhe,
9. Faton Ademi, Gjyqtarë Gjykatës Themelore – Mitrovicë, anëtarë.

Gjyqtari i Gjykatës së Apelit z.Nenad Laziq është emëruar anëtarë i PZAP-it, me vendimin e kryetarit të Gjykatës Supreme Agj.nr.241/2012 datë 09.11.2012, i cili ka mandat deri më 09.11.2016, në vend të gjyqtarit Vlastimir Dimiq, që ishte emëruar nga Kryetari i Gjykatës Supreme si antëtarë i panelit, më datë 02.11.2012 të cilit i është aprovuar kërkesa për dorëheqje si gjyqtarë i Republikës së Kosovës nga KGJK-ja po ashtu ju ka miratuar edhe kërkesa për dorëheqje si anëtarë i PZAP-it.

Gjyqtari i Gjykates së Apelit Z. Rafet Haxhaj është emëruar anëtarë i PZAP-it me vendimin e kryetarit të Gjykates Supreme GJ.A.Su.A. Nr.285/2015 të datës 18.09.2015 në vend të anëtarit Muhamet Rexha i cili është avancuar/dekretuar nga pozita e gjyqtarit të Gjykates së Apelit në pozitën e gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës.

## 2.1 Përbërja e PZAP-it

PZAP-i, përbëhet prej 10 (dhjetë) anëtarëve të panelit përfshirë këtu edhe Kryesuesen. Panelet e PZAP-it sipas LZP-së mund të mblidhen në përbërje prej së paku 3 (tre) anëtarëve. Anëtarët e PZAP-it sipas LZP-së, gjashtëdhjetë (60) ditë para ditës së zgjedhjeve, deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve, i japin përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtarë të PZAP-it.

Për çdo panel caktohet një kryesues i panelit për seancën e caktuar. Kryesuesi i Panelit të PZAP-it, i ka caktuar përbërjen e paneleve sipas Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

## 2.2 Funkcionet, përgjegjësit dhe përbërja e Sekretariatit të PZAP-it

Duke u bazuar në nenin 123 të LZP-së PZAP-i, në ushtrimin e përgjegjësive dhe funksioneve të tij ndihmohet nga Sekretariati.

Sekretariati i PZAP-it:

- pranon ankesa dhe apele gjatë procesit zgjedhor;
- arkivon të gjitha shkresat që parashtrihen në PZAP;
- Drafton/harton vendime të ndryshme;
- Me autorizim të panelit heton/mbledh fakte për vendosjen e ankesave të parashtruara në PZAP;
- Harton procesverbale për secilin rast gjatë zhvillimit të hetimeve së bashku me dëshmit e mbledhura i prezanton para panelit;
- Harton raporte të përgjithshme për rezultatin e hetimeve;
- Harton raportet preliminare për rastet që konsiderohen nga paneli së kanë elemente të veprës penale dhe i dorëzon në Prokurorinë Shtetërore të Republikës së Kosovës;
- Ofron ndihmën e nevojshme organeve të drejtësisë për ti hetuar rastet me elemente të veprës penale;
- Menaxhon dhe ekzekuton buxhetin vjetor;

- Përktihen vendimet në të gjitha gjuhët sipas ligjit për përdorimin e gjuhëve në Republikën e Kosovës;
- Mirëmban adresë zyrtare dhe qasje në informatat në çdo kohë.

Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it, nën udhëheqjen e Kryesuesen të PZAP-it, është përgjegjës për:

- Të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it;
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar së i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion;
- Organizimin e Sekretariatit dhe zhvillimin e procedurave administrative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionimin e PZAP-it.
- Menaxhon buxhetin vjetor të PZAP-i të ndarë dhe aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për të mbuluar shpenzimet për funksionimin e PZAP-it, duke u bazuar në propozim buxhetin e dorëzuar nga Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it.

Me buxhetin e propozuar për vitin 2015 dhe i cili është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës PZAP-i, nuk ka pasur ndryshime nga viti paraprak sa i përket numrit të aprovuar të stafit, respektivisht i ka të lejuara 20 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesuese të PZAP-it, 9 (nëntë) anëtarë të panelit të PZAP-it, 1 (një) Kryesues të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të administratës.


Marrëdhënia e punës së personelit të Sekretariatit të PZAP-it, rregullohet me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të datës 13 maj 2010.

Sekretariati i PZAP-it, ka këtë strukturë të brendshme të organizimit:

- Kryesuesin e Sekretariatit i cili është ekuivalent me pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë,
- Asistentin Ekzekutiv/Arkivist,
- Drejtorin e Zyrës Ligjore,
- Tre Zyrtarë të Lartë Ligjorë,
- Drejtorin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (Zyrtari Kryesor Financiar)
- Zyrtarin e Përkthimeve Shqip-Serbisht dhe anasjelltas,
- Zyrtarin për Administrimin e Teknologjisë Informative dhe Logjistikë dhe
- Zyrtar të Transportit.



### 3. ORGANOGRAMI I PZAP-it



## 4. AKTIVITETET E PZAP-IT DHE të SEKRETARIATIT

PZAP-i, në zbatim të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe përgjegjësi të tij të përcaktuara me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme të Republikës së Kosovës, në fillim të vitit ka përgatitur dhe miratuar Planin e punës për vitin 2015 në të cilin janë planifikuar dhe caktuar objektivat dhe aktivitetet e institucionit të PZAP-it.

Në këtë plan vjetorë për shkak të natyrës së punës që buron nga mandati i Institucionit të PZAP-it, detyrave dhe punëve që mund të këtë gjatë një viti, përveç planifikimit dhe caktimit të objektivave të rregullta janë planifikuar dhe caktuar edhe objektiva alternative, siç janë: caktimi i objektivave dhe aktiviteteve për ndonjë Proces Zgjedhor të Parakohëshëm për Zgjedhje të Përgjithshme apo Zgjedhje Komunale.

PZAP-i, të gjitha objektivat e parapara në Planin e Punës i ka përmbushur në afate kohore në dhe në aspektin kualitativ ashtu edhe në atë kuantitativ.

### 4.1 Mbledhjet e Panelit dhe Çështjet e Vendosura

PZAP-i gjatë vitit 2015 ka mbajtur nëntë (9) takime/mbledhje në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë marrë vendime për çështje të ndryshme që janë në mandatin e institucionit si:

- Miratimi i Planit Vjetor të Punës së PZAP-it për vitin 2015,
- Miratimi i Raportit Vjetor të PZAP-it për vitin 2014,
- Miratimi i Vendimit për Plotësimin e Komisionit të Përhershëm të PZAP-it për Çështje Ligjore,
- Miratimi i Vendimit për Plotësimin e Komisionit të Përhershëm të PZAP-it për Buxhet dhe Personel,
- Miratimi i vendimeve për lejimin dhe përdorimin e automjeteve zyrtare për zyrtaret e PZAP-it.
- Miratimi i Vendimit për vizitën e delegacionit të PZAP-it në vëzhgimin e Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me datën 21 qershor 2015 në Republikën e Shqipërisë.
- Miratimi i Vendimit për organizimin e punëtorisë së PZAP-it të mbajtur në Durrës nga data 16 - 19 prill 2015.
- Rekomandimii PZAP-it lidhur me Perfshirjen e Pagave të anëtareve dhe kryesueses së PZAP-it në Draft Ligjin për Pagat e Zyrtarëve të Lartë Publik dhe dergimin e rekomandimit në MAP
- Miratimi i Vendimit për Formimin e Grupit Punues për Planifikimin e Strategjisë së PZAP-it për periudhën 2016 – 2019.

- Miratimi i Vendimit për organizimin e punetorisë së PZAP-it të mabjtur në Durrës nga data 05 – 08 Nëntor 2015
- PZAP-i, ka vendosur lidhur me dy apele të paraqitura nga dy subjekte politike: Nga Srpska Narodna Partija Kosova (SNPK) dhe nga Partia e Pensionistëve të Kosovës (PPK).
- Këto dy subjekte politike kanë apeluar në PZAP, vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve – KQZ-së për shkak të shqiptimit të dënimit me gjobë prej nga 1,000.00 euro si dhe kamatës 0.01% për mos dorëzim të raportit financiar për vitin 2014.
- Te dy këto apele janë refuzuar nga PZAP-i, respektivisht janë vërtetuar vendimet e KQZ-së
- Vendimet e PZAP-it lidhur me apelin ndaj vendimit të KQZ-së në PZAP, janë vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës.

## 5. KOMISIONET E PËRHERSHME TË PZAP-IT

Me qëllim të përmbushjes së funksioneve dhe përgjegjësisë të tij të përcaktuara me ligj në mënyrë sa ma të lehtë, PZAP-i, ka formuar dy komisione të Përhershëm siç janë:

1. Komisioni i Përhershëm për Çështje Ligjore i përberë prej 5 (pesë), anëtarëve të panelit,
2. Komisioni i Përhershëm për Buxhet dhe Personel i përberë prej 4 (katër), anëtarëve të panelit,

Komisioni i Përhershëm për Çështje Ligjore është komision i cili përbëhet nga anëtarët e PZAP-it. Komisioni në mënyrë të përhershme merret me çështjet ligjore që kanë të bëjnë me fushën e kompetencave dhe të mandatit të Institucionit të PZAP-it, të përcaktuar me LZP dhe amendamentimin e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe nxjerrjen e Rregullave të reja për lehtësimin e funksionimit të PZAP-it.

Komisioni për çështje ligjore në vazhdimësi bën identifikimin e mangësive ligjore dhe bën rekomandime të si të amandemtohen ato.

Gjate vitit 2015 Komisioni i përhershëm për çështje ligjore në bashkëpunim me kryesuesin dhe anëtarët e PZAP-it si dhe me kryesuesin e sekretariatit dhe zyrtarët e lartë ligjor kanë identifikuar nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullave dhe procedurave të PZAP-it dhe nxjerrjen dhe miratimin e dy Rregullave të reja për lehtësimin e funksionimit të punës së PZAP-it: Rregullës për Zhvillimin e Hetimeve gjatë procesit zgjedhor dhe Rregullës për Sistemin Informativ të Menxhimit të Rasteve (ankesave dhe parashtrësive) gjate procesit zgjedhor.

Komisioni për çështje ligjore bashk me zyrtarët ligjor pas një pune intensive, mbajtjes së disa takimeve dhe punëtorisë së mbajtur në Durrës nga data 05 deri me datën 08 nëntor 2015 në të cilën punëtori kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it dhe stafi i administratës së sekretariatit të PZAP-it, janë diskutuar dhe finalizuar këto Rregulla. Ndërsa Paneli i PZAP-it në mbledhjen e mbajtur me datën 04 dhjetor 2015 ka marrë vendim për miratimin e këtyre tri Rregullave si në vijim:

- Rregulla Nr. 02/2015 Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it,
- Rregullën Nr. 03/2015 Për Sistemin dhe Menaxhimin Brendshëm të Lëndeve dhe,
- Rregullën Nr. 04/2015 Për Procedurat e Hetimit të Materialit Zgjedhor.

Komisioni për Buxhet është komision i përhershëm i cili përbëhet nga anëtarët e PZAP-it. Ky komision në mënyrë permanente shqyrton dhe jep këshilla dhe rekomandime për çështjet e buxhetit dhe të personelit të PZAP-it të cilat këshilla dhe rekomandime janë të dobishme për personelin e sekretariatit të PZAP-it. Kontributi i këtij komisioni është treguar në dhënien e këshillave profesionale personelit të sekretariatit në përgatitjen e strukturës organizative të sekretariatit, nxjerrjen dhe miratimin e Rregullores për Standardet e Organizimit të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP po ashtu komisioni për buxhet në vazhdimësi i përcjell shpenzimet e buxhetit dhe inkasimet e gjobave të subjekteve politike.

Këto komisione mbajnë takime të rregullta mujore ku shqyrtohen çështje të rëndësishme nga fushveprimtaria e PZAP-it.

## **6. KOMISIONET E PËRHERSHME TË SEKRETARIATIT**

1. Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit,
2. Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të sekretariatit.

Komisioni Disiplinor i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit, është komision i përhershëm i cili merret me çështjet e procedurave disiplinore dhe të ankesave të personelit të administratës së Sekretariatit, respektivisht me çështjet e marrëdhënies së punës të shërbyesve civil të sekretariatit.

Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i përberë prej Zyrtarëve të Lartë të Sekretariatit, ka për qëllim zgjidhjen e kontesteve të ankesave të mundshme që paraqiten nga personeli, përbrenda institucionit të PZAP-it.

Këto komisione takohen sipas nevojës dhe arsyes.

## 6.1 Komisionet e përkohshme të sekretariatit të PZAP-it

1. Komisioni për Inventarizimin e Pasurisë,
2. Komisioni për Vlerësimin e Pasurisë, dhe
3. Komisionet tjera të përkohshme.

Këto komisione kanë për qëllim menaxhimin dhe vlerësimin e pasurisë së PZAP-it, në pajtim me aktet nënligjore të Administratës Publike

## 7. AKTIVITETET E PZAP-IT PËR ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNËS SË GRAÇANICËS

Pas shpalljes së Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Graçanicës nga ana e Presidentes së vendit dhe caktimit të datës për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve me 18 janar 2015, PZAP-i, me njëherë ka filluar përgatitjen e Planit të Veprimit dhe zbatimin e tij për këto zgjedhje.

Prej shpalljes së zgjedhjeve e deri me certifikimin e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve nga KQZ-së, PZAP-i ka kryer një mori aktivitete.

Ka përgatitur Planin e Veprimit për Zgjedhjet në Graçanicë me të cilin plan janë planifikuar të gjitha aktivitetet e duhura për këtë proces zgjedhor.

Ka miratuar vendimin për caktimin e tri (3) Paneleve të PZAP-it, me të cilin vendim janë caktuar tre panele me nga tre anëtarë të panelit dhe zëvendësit e tyre për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në seancat e panelit.

Ka miratuar Vendimin për punë jashtë orarit të punës dhe Planin e punës për punë jashtë orarit të punës për zyrtarët e sekretariatit të PZAP-it. Prej datës 5 janar 2015 deri me certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar të komunës në Graçanicë. Zyrtarët e sekretariatit kanë punuar jashtë orarit të punës për të pranuar ankesa lidhur me këtë proces zgjedhor, por që për këtë proces zgjedhor nuk ka pasur asnjë ankesë.

Ka miratuar vendimin për kompensimin/pagesën e orëve jashtë orarit të punës për stafin e administratës së sekretariatit të PZAP-it. Në zbatim të këtij vendimi, zyrtarët e sekretariatit për punën e realizuar jashtë orarit të punës gjatë gjithë procesit zgjedhor deri me certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Graçanicës, janë kompensuar me pagë shtesë. Kompensimi është bërë në përputhje me Ligjin e Shërbimit Civil, jo më shumë se 40 orë në muaj.

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it i ka shpërndarë Formularët e ankesave nëpër Qendrat e Votimit në Komunën e Graçanicës para ditës së zgjedhjeve.

Për procesin zgjedhor për Kryetar të Komunes së Graçanicës, PZAP-i – me Komisionin Qendror Zgjedhor – KQZ ka pasur komunikim dhe bashkëpunim të zakonshëm.

PZAP-i, sipas kërkesës e ka njoftuar KQZ-në me emrat e personave të cilët me vendim të PZAP-it ju është ndaluar e drejta që të jenë kandidatë për zgjedhje dhe pjesë e stafit administrativ të zgjedhjeve që organizohen nga KQZ-ja, si dhe e ka njoftuar me gjobat e papaguara nga ana e subjekteve politike para certifikimit të subjekteve politike dhe kandidatëve për të marrë pjesë në garën për kryetar të komunës.

Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave në PZAP për këtë proces zgjedhor, PZAP-i sipas kërkesës së KQZ-së, ka konfirmuar me shkrim KQZ-ne për përfundimin e afatit të paraqitjes dhe vendosjes së ankesave nga ana e PZAP-it lidhur me procesin zgjedhor me çka i ka mundësuar KQZ-se certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve në afatin kohorë.

## **8. PUNËTORITË E PZAP-IT TË MBAJTURA NË VITIN 2015**

Më qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të stafit, rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në punë për çështje të ndryshme PZAP-i, gjatë vitit 2015 ka organizuar dy punëtori në Durrës në periudha të ndryshme kohore.

Punëtorja e parë e organizuar nga PZAP-i është mbajtur nga data 16 – 19 prill 2015, në të cilën punëtori kanë marrë pjesëtarët e PZAP-it dhe personeli i administratës së sekretariatit të PZAP-it si dhe përfaqësues nga OSBE-ja dhe IFES-i dhe janë diskutuar temat dhe çështjet si më posht:

- Krahasimi i shkeljeve të Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhor për proceset e zgjedhjeve 2009 – 2014.
- Krahasimi i Hetimeve të zhvilluara nga PZAP-i për proceset e zgjedhjeve 2009 – 2014
- Komunikimi i PZAP-it me subjektet politike dhe institucionet tjera për proceset e zgjedhjeve 2009 – 2014.
- Inkasimi i gjobave të papaguara nga subjektet politike dhe mënyra/modaliteti i procedimi të vendime me gjoba në rastet kur subjektet politike nuk janë më aktive si subjekte politike në Kosovë, ndërsa ende nuk u kanë shlyer borxhet në PZAP.
- Prezantim dhe miratimi i Raportit të punës së PZAP-it për vitin 2014;
- Është bërë prezantim dhe miratimi i Planit të Punës për vitin 2015;

Ndërsa punëtoria tjetër e organizuar nga PZAP-i, në vitin 2015, ka qenë nga data 05 – 08 Nëntor 2015, në të cilën punëtori kane marrë pjesë anëtarët e PZAP-it dhe personeli i administratës së sekretariatit të PZAP-it si dhe përfaqësues nga OSBE-ja dhe IFES-i dhe janë diskutuar temat dhe çështje si më poshtë:

- Shqyrtimi i raportit nëntë mujore të PZAP-it për vitin 2015 dhe Shqyrtimi i Draftit të Planit Vjetor të Punës për vitin 2016.
- Prezantim i Raportit të Buxhetit dhe i shpenzimeve për periudhën Janar, Shtator 2015
- Shqyrtimi dhe diskutimi lidhur me plotësimin, ndryshimin dhe finalizimin e Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.
- Shqyrtimi dhe diskutimi lidhur me përgatitjen dhe finalizimin e Rregullës për zhvillimin e hetimeve të ankesave që kanë të bëjnë me Qendrën e Numërimit dhe të Rezultateve dhe ankesave për parregullesit në teren gjatë proceseve zgjedhore.
- Shqyrtimi dhe diskutimi lidhur me përgatitjen dhe finalizimi i Rregullës së Brendshme për Regjistrimin dhe Arkivimin elektronik të ankesave
- Shqyrtimi dhe diskutimi lidhur me Përgatitjen dhe finalizimin e Udhëzimit Administrativ për Postimin e Informacioneve në Ueb Faqen e PZAP-it

Nga të gjitha ato që janë diskutuar në të dy punëtorit janë nxjerrë mësimet dhe rekomandime si dhe konkluzione se si të vepron PZAP-i, në të ardhmen.

Gjithashtu gjatë vitit 2015, PZAP-it ka mbajtur tri punëtori të cilat i ka organizuar dhe mbështetur financiarisht IFES-i. Punëtorit kanë pasur për qëllim përgatitjen e dokumentit për Planifikimin Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019. Në këto punëtori ka marrë pjesë grupi punues i emëruar me vendim të PZAP-it dhe ekspertë të IFES-it si dhe ekspert ndërkombëtar të angazhuar nga IFES-i. Gjatë vitit të kaluar grupi punues ka arritur që të përfundojë një pjesë të madhe të këtij dokumenti: Misionin e PZAP-it, Vizionin e PZAP-it, Parimet Orientuese, Shtyllat Strategjike, Synimet dhe Objektivat Strategjike të PZAP-it. Ndërsa pjesa tjetër e dokumentit ka mbetur të punohet dhe të përfundohet gjatë vitit 2016.

### **8.1 Pjesëmarrja e anëtarëve të PZAP-it dhe personelit të sekretariatit të PZAP-it në vizita, trajnime dhe punëtori në vend dhe jashtë vendit**

Anëtarët dhe Personeli i Sekretariatit të PZAP-it me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve të brendshme të Institucionit dhe performancës së tij kanë marrë pjesë në vizita studimore, trajnime dhe seminare të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

## 8.2 Vizita në Republikën e Shqipërisë

Një delegacion i PZAP-it në përbërje nga Kryesuesja e PZAP-it, 3 (tre) anëtarë të panelit, kryesuesi i Sekretariatit, dhe tre zyrtar tjerë të Sekretariatit të PZAP-it, kanë marrë pjesë në vëzhgimin e procesit zgjedhor të Zgjedhjeve të Rregullta Lokale në Republikën e Shqipërisë të cilat janë mbajtur me datën 21 qershor 2015, e cila vizitë është organizuar me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të Institucionit, përfitimin e njohurive dhe këmbimin e përvojave me institucionet e Republikës së Shqipërisë të cilat merren me organizimin e Zgjedhjeve dhe mbrojtjen e të drejtës së votës, respektivisht me perfaqësuesit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe perfaqësuesit e Kolegjit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Gjate vizitës për vëzhgimin e këtyre zgjedhjeve delegacioni i PZAP-it është takuar me Kryetaren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetarin e Gjykatës së Apelit të Tiranës me disa anëtarë të Kolegjit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu delegacioni ka vëzhguar një proces gjykues të Kolegjit Zgjedhor lidhur me parregullesit zgjedhore, si dhe gjate ditës së zgjedhjeve prej hapjes së vendotimeve e deri në mbylljen e tyre delegacioni i PZAP-it ka vizituar dhe ka vëzhguar shume Qendra të Votimit, respektivisht Vendvotime.

## 9. AKTIVITETET LIDHUR ME ÇËSHTJET E PERSONELIT TË SEKRETARIATIT TË PZAP-IT

- Përgatitja e Planit Individual të Personelit dhe dorëzimi i tij në MAP,
- Përgatitja e Pyetësorit lidhur me të dhënat e shërbyesve civil të sekretariatit të PZAP-it për vitin 2014,
- Plani Vjetor i Trajnimit për shërbyesit civil të SPZAP-it për vitin 2015,
- Përgatitja e Planit Vjetor të Pushimeve Vjetore të personelit të SPZAP-it për vitin 2015,
- Përgatitja e Planeve të Punës të Departamenteve dhe të Sekretariatit të PZAP-it në Përgjithësi për vitin 2015,
- Dorëzimi i listes me emrat e zyrtarëve të lartë publik të institucionit të PZAP-it në Agjencionin Kundër Korrupsionit.
- Përgatitja e Katalogut të Vendeve të Punës për Shërbyesit Civil të Sekretariatit të PZAP-it, Katalogu i vendeve të punës së shërbyesve civil në SPZAP është bërë sipas Vendimit të Qeverisë dhe një Qarkore Administrative të Ministrisë së Administratës Publike – MAP, që kanë për qëllim standardizimin e vendeve të punës, përshkrimin e detyrave të punës dhe vendosjen e gradave adekuate për çdo vend pune.
- Duke u bazuar në Ligjin Nr. 02/L- 28 Për Procedurën Administrative dhe Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 06/29 të datës 15.05.2015 dhe konform Qarkores së Ministrisë së Administratës Publike -MAP, për njohjen e përvojës së punës së Nëpunësve Civil PZAP-i ka dërguar në MAP listen e stafit të sekretariatit të PZAP-it



me të dhenat për përvojën e punës dhe ka nxjerrur vendim për përvojën e punës për secilin nëpunës civil të SPZAP-it.

- Përfundimi i procedurave të Vlerësimit të punës të zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it për vitin 2015, futja e këtyre të dhenave në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerezore (SIMBNJ) në Ministrinë e Administratës Publike (MAP).
- Regjistrimi dhe futja e të gjitha të dhënave nga dosja e personelit të nëpunësve civil të sekretariatit të PZAP-it në Sistemin Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerezore (SIMBNJ),
- Per shkak të dekretimit nga ana Presidentes së Republikës së Kosovës të Drejtorit të Departamentit Ligjor të SPZAP-it z. Adnan Konushevcit në pozitën e Gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë me datën 20.05.2015 kjo pozitë ka mbetur e lirë dhe për të plotësuar këtë pozitë PZAP-i ka inicuar procedurë për plotësimin e kësaj pozite. Procedura është zhvilluar në mënyrë elektronike përmes Sistemit Informativ të Menaxhimit të Burimeve Njerezore (SIMBNJ) të Ministrisë së Administratës Publike, por ende nuk është përfunduar.

## 10. AKTIVITETET E PROKURIMIT PËR NEVOJA TË PZAP-IT

- Monitorimi i kontratës me titull “Servisimi dhe Mirëmbajta e Teknologjisë Informative të PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 31.12.2017.
- Monitorimi i kontratës me titull “Sigurimi i Automjeteve të PZAP-it”, Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 16.08.2016,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit dhe nënshkrimi si dhe monitorimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet e Pastrimit dhe Mirëmbajtja e Hapësirave të PZAP-it”, Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 07.03.2018,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit dhe nënshkrimi si dhe monitorimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Material Zyrtar PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 26.03.2018,
- Monitorimi i kontratës me titull “Furnizim me karburante për automjete të PZAP-it”. Kohëzgjatja e kësaj kontrate është deri me 19.09.2017,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit dhe nënshkrimi si dhe monitorimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i automjeteve të PZAP-it”. Kontrata është nënshkruar me 29.12.2015,
- Zhvillimi i Procedurave të Prokurimit dhe nënshkrimi si dhe monitorimi i kontratës për Aktivitetin e prokurimit me titull “Pastrimi i automjeteve të PZAP-it”. Kontrata është nënshkruar me 03.11.2015,

## 11. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT PËR FINANCA DHE SHËRBIME TË PËRGJITHSHME

### 11.1 Aktivitetet e buxhetit dhe financave

- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH 2016-2018) për vitin 2016 si dhe vlerësimet për dy vite tjera 2017 dhe 2018, ku në KASH përfshihen Misioni i PZAP-it, Situata Aktuale si dhe Objektivat e PZAP-it në një periudhë afatmesme,
- Përgatitja e kërkesave buxhetore të PZAP-it për vitin 2016 dhe parashikimet për vitet 2017 dhe 2018,
- Monitorimi dhe përcjellja e Librit Financiar ku mbahet evidenca e të gjitha transaksioneve të shpenzimeve,
- Përgatitja e Pasqyrave Financiare për vitin 2015 dhe dorëzimi i tyre në Ministrinë e Financave;
- Barazimi vjetor i shpenzimeve në SIMFK me librin financiar të SPZAP-it për vitin fiskal 2015,
- Përgatitja e dokumentacionit për Cash Plan të Buxhetit për vitin 2016 dhe futja e të dhënave në Softverin e Cash Planit duke planifikuar shpenzimet dhe zotimet në baza mujore për secilën kategori ekonomike,
- Përgatitja e dokumentacionit për tërheqjen – hapjen e Petty Cashit si dhe menaxhimin e parave të imta,
- Përgatitja e dokumentacionit për pagesë të secilit shpenzim të ndodhur,
- Koordinim të aktiviteteve me zyrtarin zotues për zotimin e mjeteve financiare, me zyrtarin pranues, me zyrtarin certifikues për certifikimin e dokumenteve financiare si dhe me zyrtarin e prokurimit për aprovim të dokumenteve financiare me procedurë të prokurimit,
- Përgatitja e të gjitha dokumenteve të duhura dhe ndjekja e të gjitha procedurave ligjore për hapjen e vitit buxhetor për vitin 2015 ashtu siç kërkohet me Ligjin për Financat Publike dhe Përgjegjësitë. ( Caktimi i personave të autorizuar, Zyrtarin Zotues, Zyrtarin Shpenzues, Zyrtarin Pranues, Zyrtarin Aprovues).
- Regjistrimi i pasurisë së Institucionit – Inventarizimi, Vlerësimi dhe tjetërsimi i pasurisë nga ana e komisioneve të formuara nga kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it, Procedimi dhe kontrollimi i të gjitha faturave që janë për pagesë;
- Përgatitja e Raportit për Inventarizim dhe Vlerësim të Pasurisë në bazë të Udhëzimeve Administrative që janë në zbatim;
- Regjistrimi i pasurisë si për inventar ashtu edhe për material administrativ në SIMFK dhe në sistemin e E-pasurisë;
- Plotësimi i Formularit/Pyetsorit për Vetëvlerësim e performances së institucionit të PZAP-it për vitin 2015 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollim, i cili vetëvlerësim kërkohet nga Njësia Qendore Harmonizuese (NQH) e Ministrisë së Financave (MF).
- Regjistrimi dhe monitorimi i të hyrave të realizuara nga ana e zyrtarit të të hyrave.

- Pjesëmarrja e stafit të Sekretariatit në trajnim në MF në Departamentin e Thesarit për versionin e ri të SIMFK për zyrtar shpenzues, trajnimi ka zgjatë tri ditë.
- Pjesëmarrja e zyrtarit të pranimit në trajnim dy ditor të organizuar nga MF për modulën e pranimit të mallit në Free Balance version 7,
- Pjesëmarrja e zyrtarit të të hyrave në trajnim dy ditor të organizuar nga MF për modulën e të hyrave në Free Balance version 7,
- Pjesëmarrja e zyrtarëve të sekretariatit në komisione vlerësuese për vlerësimin e ofertave të ndryshme për aktivitetet e prokurimit që PZAP-i i ka zhvilluar gjatë vitit.
- Përpilimi i Raporteve të vlerësimit të ofertave të ndryshme për aktivitetet e prokurimit që PZAP-i i ka zhvilluar gjatë vitit.

## **11.2 Aktivitetet për koordinimin e përkthimit të dokumenteve të PZAP-it**

PZAP-i, në pajtim me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve i ka përkthyer të gjitha vendimet dhe dokumentet tjera nga gjuha shqipe në atë serbe dhe anasjelltas:

- Përkthimi i raportit vjetor të PZAP-it për vitin 2014,
- Përkthimi i planit të punës së PZAP-it për vitin 2015,
- Përkthimi i të gjitha Rregullave dhe Procedurave të Brendshme të PZAP-it,
- Përkthimi i materialeve të zyrtareve të sekretariatit që i kanë përgatitur për prezantim në punëtoritë e PZAP-it,
- Përkthim i të gjitha njoftimeve për kontratë për aktivitetet e prokurimit që PZAP-i i ka zhvilluar gjatë vitit.
- Përkthimin e dokumenteve të PZAP-it për Ministrinë e Financave : Raportet tremujore të Buxhetit të PZAP-it për vitin 2015, Kerkesat buxhetore për vitin 2016, Kornizen Afatmesme të Shpenzimeve (KASH) për vitin 2016 – 2018 etj.,
- Njoftimet për web faqe zyrtare të PZAP-it,
- Biografite dhe informatat tjera të gjyqtareve për web faqe,
- Agjendat për punëtoritë e PZAP-it dhe takimet e PZAP-it,
- Procesverbalet nga takimet dhe punëtoritë e e PZAP-it,
- Njoftimet për dhënie të kontratës për Aktivitetet e Prokurimit të PZAP-it,
- Njoftimet paralajmëruese për pagesat e gjobave,
- Propozimet për përmbarrim e vendimeve të PZAP-it për gjobat e papaguara;
- Format e e aplikacionit (data bazës) të Sistemit për Menaxhimin Elektronik të Rasteve

### 11.3 Aktivitetet e teknologjisë informative dhe logjistikës

- Mbajtja e takimit me zyrtaret e e Pasurisë në zyrat e MAP-it rreth disa problemeve të zhvlerësimit të pasurisë dhe rregullimi i tyre;
- Përgatitja e kërkesës me specifika teknike për Aktivitetin e Prokurimit - Shërbimet e pastrimit dhe të mirëmbajtjes së hapsirave të PZAP-it;
- Përgatitja e kërkesës me specifika teknike për Aktivitetin e Prokurimit - Furnizim me material zyrtar;
- Përgatitja e Raportit Vjetor Financiar të Pasurive Kapitale dhe Jo-Kapitale;
- Mbajtja e disa takimeve në mes të zyrtarit të TI-së të sekretariatit të PZAP-it me zyrtaret e IFES-it dhe OSBE-së rreth përgatitjes së dokumentit për kërkesat e programit të sistemit të menaxhimit të ankesave/apeleve dhe shkresave të lëndës.
- Mbajtja e disa takimeve në mes të zyrtarit të TI-së të sekretariatit të PZAP-it me zyrtaret e IFES-it për vlerësimin e ofertave të kompanive të interesuara dhe të cilat kanë ofertuar për Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Rasteve;
- Kryerja e detyrave tjera të përditshme si zyrtar i Teknologjisë Informative, zotues, i PETY Kesh-it dhe i pasurisë
- Zyrtari i TI-së ka kryer trajnimin në MF për SIMFK v7 në modulën e pasurive.
- Monitorimi dhe Menaxhimi në aspektin profesional i kontratës për servisimin e pajisjeve të TI-së të PZAP-it, identifikimi i nevojave për servisim, mbajtja e kontakteve me kompaninë kontraktuese lidhur me përmbushjen obligimeve të tyre kontraktuale për punë dhe shërbime të TI-së, mbikëqyrja dhe servisimi i pajisjeve të TI-së etj.;
- Përgatitur specifikimet teknike të nevojave të PZAP-it për zhvillimin e procedurave të centralizuara të prokurimit nga Agjencia Qendrore e Prokurimit (AQP-ja) për material zyrtar, shpenzime të karburanteve dhe udhëtime jashtë vendit.
- AQP-ja procedurat e centralizuara të prokurimit për këto aktivitetet të prokurimit i zhvillon për autoritetet kontraktuese të Kosovës. Pas lidhjes së kontratave në mes të AQP-së me operatoret ekonomik që e kanë fituar tenderin për të kryer këto shërbime dhe furnizime, institucionet e Kosoves në këtë rast edhe PZAP-i ka të drejten e shfrytëzimit të këtyre kontrateve për këto shërbime dhe furnizime.
- Menaxhimin e depos, furnizimin e zyrtarëve të PZAP-it me inventar dhe material administrativ sipas kërkesave të zyrtarëve;
- Koordinimin e aktivitetëve në lidhje me akomodimin brenda ndërtesës dhe koordinimi për çështjet e logjistikës;
- Përgatitja e specifikave për çështje të logjistikës për aktivitetet të prokurimit si dhe për mirëmbajtjen e hapsirave të ndërtesës;

## 11.4 Aktivitetet e zyrës së transportit

- Menaxhimi i automjeteve zyrtare;
- Mirëmbajtja e përditshme e automjeteve zyrtare;
- Mbajtja e evidencave për qarkullimin e veturave zyrtare si dhe evidentimi i kilometrave të kaluara;
- Regjistrimin dhe sigurimin me kohë të automjeteve zyrtare;
- Përcjellja dhe kontrollimi i faturave dhe kuponëve për furnizim me derivate;
- Raportim për kilometrat e kaluara të automjeteve zyrtare;
- Shërbime me vetura sipas kërkesave të zyrtarëve;
- Dërgimi i dokumenteve zyrtare të PZAP-it në vende të ndryshme brenda Prishtinës dhe në qendra tjera jashtë Prishtinës;

## 12. AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT LIGJOR

- Zyra ligjore e sekretariatit të PZAP-it në menyrë të vazhdueshme ka mbështetur punën e Komisionit për Çështje ligjore të PZAP-it në përgatitjen e akteve nënligjore;
- Përgatitja e Draft Rregullave të PZAP-it,
- Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it,
- Rregullen Për Sistemin dhe Menaxhimin e Brendshëm të Lëndeve dhe,
- Rregullen Për Procedurat e Hetimit të Materialit Zgjedhor.
- Ka mbështetur me punë profesionale Grupin punës të PZAP-it në përgatitjen e dokumentit të Planifikimit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019.
- Zyra ligjore gjatë gjithë vitit ka ofruar ekspertizën profesionale dhe praktikën e mira për krijimin e programit për sistemin e menaxhimit të ankesave/apelve dhe shkresave tjera të lëndës, në projektin e financuar nga IFES-i dhe i mbështetur nga OSBE me punën aktive profesionale.
- Zyrtarët e zyrës ligjore në bashkëpunim me kryesuesin e sekretariatit, zyrtarin e teknologjisë informative dhe zyrtaret tjerë të PZAP-it, si dhe në bashkëpunim me zyrtaret e IFES-it dhe Kompanisë “Cactus”, pas një pune mjaft intensive kanë arritur që të përfundojnë punën lidhur me krijimin e programit për Sistemin e Menaxhimit të ankesave/apelve dhe shkresave tjera të lëndës. Këtë projekt financiarisht dhe me punë organizative e profesionale e ka mbështetur IFES-i. Ndërsa me punë aktive profesionale prej fillimit e deri në përfundimin e tij e ka mbështetur edhe OSBE-ja.
- Pjesëmarrja në katër (4) punëtori të organizuara nga IFES, me temën “Qasja në procese zgjedhore të personave me nevoja të veçanta”,

### **13. AKTIVITETET LIDHUR ME PËRMBARIMIN E VENDIMEVE TË PZAP-it LIDHUR ME GJOBAT E SHQIPTUARA NDAJ SUBJEKTEVE POLITIKE**

- Rishikimi i statusit aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga viti 2009 e deri me 2014 dhe gjetja e modalitetit për përmbarimin e vendimeve të PZAP-it lidhur me gjobat e papaguara nga subjektet politike (për këtë çështje kemi kërkuar nga KQZ-ja të na njofton së cilat subjekte politike janë ende aktive e cilat janë pasive apo cilat nuk janë çregjistruar dhe cilat janë çregjistruar nga KQZ-ja).
- Pas marrjes së përgjigjes nga KQZ-ja dhe informacioneve të hollësishme lidhur me statusin aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga viti 2009 e deri me 2014, PZAP-i ka filluar procedurën e përmbarimit të vendimeve të tij lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike.
- Me përmbaruesin privat kemi biseduar dhe jemi dakorduar për fillimin e procedurës ligjore të përmbarimit të vendimeve të PZAP-it lidhur me gjobat e papaguara të subjekteve politike për periudhën e zgjedhjeve nga viti 2009 – 2014.
- Fillimisht kemi përgatitur materialet e nevojshme për përmbarimin e vendimeve të PZAP-it për zgjedhjet e vitit 2009/10 dhe 2010/11 dhe dorëzimin e këtyre materialeve Zyres së Përmbaruesit Privat.
- Për zgjedhjet e vitit 2009/10, janë të pa përmbaruara 15 vendime të PZAP-it, ndërsa shuma e gjobave është 19,000.00 €; Prej 19,000.00 € janë paguar 313.00€, ndërsa kanë mbetur pa paguar edhe 18,687.00 €.
- Për zgjedhjet e vitit 2010/11, janë të pa përmbaruara 3 vendime të PZAP-it ndërsa shuma e gjobave është 5,550.00 €;
- Gjithsejtë: për këto dy palë zgjedhje janë të pa përmbaruara 20 vendime; ndërsa lartësia e gjobave është 24,237.00 €.
- Për zgjedhjet e vitit 2013 shuma e gjobave të papaguara ka qenë 1,150.00 euro;
- Për këto zgjedhje në vitin 2015 ju kemi dërguar paralajmërim për pagesën e gjobave të papaguara katër subjekteve politike. Prej katër subjekteve politike të paralajmëruara për pagesën e gjobave të papaguara dy subjekte politike i kanë paguar shumën prej 500.00 euro ndërsa dy subjekte tjera nuk i kanë paguar.
- Per këto zgjedhje kanë mbetur të papaguara edhe 650.00 euro.
- Për zgjedhjet e vitit 2013, por që denimet janë shqiptuar në vitin 2014 kanë mbetur të papaguara edhe 4,900.00 €,
- Për Zgjedhjet e vitit 2014, shuma e gjobave të shqiptuara ka qenë 86,700.00 €. Për këto zgjedhje të gjitha subjektet politike i kanë paguar gjobat me përjashtim të një subjekti i cili ka mbetur pa e paguar gjobën prej 250.00 €,
- Gjithsej borxhe të papaguara për të gjitha proceset zgjedhore prej vitit 2009 - 2014 janë: 30,037.00 € .
- Drejtori i Zyrës ligjore së bashku me zyrtaret ligjore dhe asistenten ekzekutive të kryesuesit të sekretariatit të PZAP-it, i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e duhura ligjore për të kompletuar të gjitha materialet e duhura për përmbaruesin në mënyrë që të

lehtësohet puna e përmbaruesit për përmbarimin e vendimeve të PZAP-it lidhur me gjobat e papaguara.

#### **14. BASHKËPUNIMI I PZAP-IT ME KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR (KQZ)**

Gjatë vitit 2015 Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP dhe Komisioni Qendror Zgjedhor – KQZ, me qëllim të përmirësimit të komunikimit dhe bashkëpunimit reciprok në mes të këtyre dy institucioneve kanë organizuar dy takime pune/punëtori me stafin e Sekretariatit të PZAP-it dhe stafin e Sekretariatit të KQZ-së.

Takimi/punëtorja i/e parë një ditore është organizuar nga PZAP-i me datën 28 maj 2015. Ndërsa takimi/punëtorja i/e dyte është organizuar nga KQZ-ja me datën 18 nëntor 2015.

Ne të dy këto takime/punëtori janë diskutuar dhe shqyrtuar tema me interes reciprok të cilat në të ardhmën do të ndihmojnë në përmirësimin e komunikimit dhe të bashkëpunimit në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme – LZP, në mes të sekretariateve të PZAP-it dhe KQZ – së.

Me theks të veçantë është shqyrtuar mundësia e përmirësimit të komunikimit dhe bashkëpunimit në mes të PZAP-it dhe KQZ-se, lidhur me procesin e regjistrimit e certifikimit të subjekteve politike, kandidatëve dhe akreditimin e vëzhguesve, lidhur me procesin e ankesave dhe parashtrësive gjatë procesit zgjedhor, lidhur me procesin e votimit jashtë Kosovës dhe lidhur me ankesat për Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR). Gjatë trajtimit dhe diskutimit të këtyre temave nga pjesëmarrësit janë identifikuar disa pengesa nga proceset e kaluara zgjedhore si dhe janë shqyrtuar mundësitë ligjore dhe gjetja e praktikave të mira të tejkalimit të këtyre pengesave për të lehtësuar punën në të ardhmen.

## **15. BASHKËPUNIM ME ORGANIZATEN PËR SIGURI DHE BASHKEPUNIM EUROPIAN - OSBE**

OSBE-ja, si çdoherë me qellim të ngritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve, ka ofruar përkrahje PZAP-it, në aspektin këshillues profesional në organizimin e punetorive për anetaret e PZAP-it dhe stafin e sekretariatit.

Me datën 09 qershor 2015 OSBE-ja, për anetaret e PZAP-it dhe stafin e sekretariatit të PZAP-it ka organizuar punëtori me temën: Trajnimi i Trupave Menaxhuese Zgjedhore mbi përfshirjen gjinore. në kete punëtori janë diskutuar qeshtjet lidhur me përfshirjen gjinore aktuale në trupat menaxhuese zgjedhore, instrumentet ligjore nderkombetare dhe korniza ligjore në Kosove të cilat e rregulloje pjesëmarrjen e gjinisë femërorë në zgjedhje.

Me datën 22 tetor 2015 Kryesuesi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, ka organizuar Konferencë për proceset zgjedhore në Kosovë. në këtë konferencë kane marre pjese përfaqësues të institucioneve zgjedhore të Kosoves dhe të vendeve të rajonit si: Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Republikës së Shqiperise dhe nga Komisioni Shteteror Zgjedhor i Republikes së Maqedonise si dhe përfaqësues të partive politike të Kosoves dhe të shoqërisë civile. në mungese të kryesueses në kete konferencë PZAP-in e ka përfaqësuar një anetare i PZAP-it dhe kryesuesi i sekretariatit. Konferenca ka trajtuar tema të rëndësishme për proceset zgjedhore në Kosove si: Roli i Partive Politike në Zgjedhje, Permbledhja e raporteve të fundit të vëzhguesve qe kane të bëjnë me partit politike. Dialogu i partive politike me KQZ-ne. Korniza rregullative mbi partit politike në Kosove etj.

Me datën 23 nëntor 2015 OSBE-ja ka organizuar punëtori me Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - KQZ, Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parshtresa - PZAP dhe Organizatat e Shoqerisë Civile - OSHC. në kete punëtori kane marre pjese kryesuesja dhe anëtarët e PZAP-it dhe kryesuesit të sekretariatit të PZAP-it, Kryesuesja dhe anetaret e KQZ-së si dhe stafi i sekretariatit të KQZ-se dhe përfaqësues të OSHC-së dhe janë diskutuar Pikëpamjet e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) lidhur me bashkëpunimin e nevojshëm me TMZ (KQZ-se) dhe PZAP-it. Pikëpamjet e KQZ-se në lidhje me mbështetjen qe do tu ofrohet OSHC-ve, Pikëpamjet e PZAP-it në lidhje me mbështetjen qe do tu ofrohet OSHC-ve si dhe diskutimi për hartimin e një Memorandumi të mirëkuptimit në mes të KQZ-se, PZAP-it dhe OSHC-ve.

Me datën 10 dhjetor 2015 OSBE-ja ka organizuar punëtori me Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parshtresa – PZAP mbi mësimet e nxjerra. Mbeshteja dhe Organizimi i kësaj punëtori nga OSBE-ja ka pasur për qellim ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të anetareve dhe stafit të sekretariatit. Temat e diskutimit kane qene Vleresimi i përgjithshëm i performances së PZAP-it në vitin 2015 Vleresimi i qeshtjeve tematike (zbatimi i rekomandimeve nga mësimet e nxjerrate vititi 2014; Sistemi i Menaxhimit të Rasteve, ndryshimi dhe miratimi i rregullave të



PZAP-it , zbatimi i gjobave të papaguara, çështjet e personelit dhe të buxhetit si dhe diskutimi i planit të punës për vitin 2016 duke përfshirë Planin Strategjik të PZAP-it.

OSBE-ja përmes zyrtarëve të saj prej fillimit të projektit për Sistemin e Menaxhimit të Rasteve e deri në perfundimin e projektit ka ofruar perkrahje të vazhdueshme profesionale.

Me zyrtarët e Departamentit të Zgjedhjeve të OSBE-së në vazhdimësi kemi pasur takime të herë pashershme pune dhe kemi diskutuar për çështje me interes për PZAP-in.

## **16. BASHKËPUNIM ME FONDIN NDERKOMBETAR PËR SISTEME ZGJEDHORE - IFES**

Fondacionin Ndërkombëtar për Sistemin Zgjedhor - IFES së bashku me OSBE-në dhe personelin e PZAP-it sipas kërkesës dhe nevojave të PZAP-it kanë punuar dhe përfunduar programin Softverik për menaxhimin e ankesave/apelve dhe shkresave të lëndës gjatë një procesi zgjedhor.

Për arritjen e përfundimit të këtij projekti është nevojitur një kohë e gjatë e punës, janë zhvilluar shumë aktivitete dhe janë mbajtur shume takime në mes të stafit të PZAP-it, stafit të IFES-it si dhe stafit kompanisë e cila ka fituar tenderin për përgatitjen e softverit.

IFES-i ka përkrahur institucionin e PZAP-it duke angazhuar 5 zyrtar për të regjistruar dhe arkivuar të gjitha ankesat në këtë sistem informative nga viti 2009 deri në vitin 2014 pra në këtë sistem informative janë arkivuar të gjitha ankesat dhe shkresat e lendes për të gjitha proceset zgjedhore të cekura më lartë.

Arkivimi elektronik e rasteve në sistemin informative është i rëndësishëm për arsye statistikore duke i analizuar dhe krahasuar proceset zgjedhore në të kaluarën dhe marrjen e masave për përmirësimin e proceseve zgjedhore në të ardhmen. Arkivimi elektronik i ankesave dhe parashtrës në këtë kohë ka pasur rëndësinë e vet edhe për faktin e testimit të funksionimit të sistemit në këtë kohë kur nuk kemi zgjedhje.

Gjithashtu IFES-i gjatë vitit 2015 i ka ofruar përkrahje PZAP-it në përgatitjen e dokumentit të rëndësishëm për të Planifikimit Strategjik të PZAP-it për periudhën 2016 – 2019. për hartimin e këtij dokumenti janë mbajtur/organizuar tri punëtori nga IFES-i në të cilat punëtori kanë marrë pjesë grupi punues i emëruar me vendim të PZAP-it dhe ekspertë të IFES-it si dhe ekspertë ndërkombëtar të angazhuar nga IFES-i.

Gjatë vitit të kaluar është punuar dhe është përfunduar një pjesë e madhe e këtij dokumenti: Misioni, Vizioni, Parimet Orientuese, Shtyllat, Synimet dhe Objektivat Strategjike. Ndërsa pjesa tjetër e dokumentit ka mbetur të përfundohet gjatë vitit 2016.

## **17. RAPORTI I BUXHETIT DHE SHPENZIMEVE VJETORE PËR VITIN FISKAL-2015**

### **17.1 Ndarjet Buxhetore**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa është organizatë buxhetore, me kod organizativ 247 dhe me kod funksional 0160. PZAP-i financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Raporti vjetor i shpenzimeve për vitin fiskal 2015 përmban të gjitha shpenzimet e krijuara gjatë këtij viti. Ky raport është përgatitur në pajtim me LMFPP (03/L-48) dhe SNKSP dhe sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tërë periudhës së realizimit të shpenzimeve.

Bazë për hartimin e dokumentit kanë shërbyer raportet e SIMFK, të dhënat nga sektori i financave si librat, faturat, raportet e pranimi të mallit, kontratat dhe dokumentet tjera të PZAP-it.

Të gjitha pagesat janë bërë në sistemin e KESH-it (parave të gatshme) e jo të zotimit.

Valuta raportuese është euro (€)

Shumat raportuese janë në njësi në €

## 18. BUXHETI I APROVUAR PËR VITIN 2015

Me ligjin e Buxhetit të Kosovës nr. 05/L-001 për vitin 2015 për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë buxhet në shumë prej 266,413.00€.

Me ligjin Nr. 05/L -046 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-001 Për Buxhetin e Republikës së Kosovës, buxheti i PZAP-së gjatë këtij viti ka pësuar ndryshime ku është shkurtuar në dy kategoritë ekonomike, paga e mëditje dhe në mallra e shërbime. Buxheti në total është shkurtuar për 56,774€, përkatësisht në paga dhe mëditje buxheti është shkurtuar për 45,774€, në mallra e shërbime buxheti është shkurtuar për 11,061€. Shkurtime në buxhet kemi pasur edhe në fund të vitit 2015 në shumë prej 37,646€.

Me vendimet e Qeverisë nr 12/64 të datës 16.12.2015, dhe nr. 9/65 të datës 23.12.2015 buxheti është shkurtuar në tri kategorit, në kategorin e pagave shkurtime buxhetor ka qenë 4,714 €, në kategorin e mallrave 30,330 euro dhe në kategorin e shërbimeve komunale 2,602.


Në mënyrë të detajuar janë të paraqitura në formë tabelare;

### Buxheti fillestar i aprovuar dhe buxheti i ndryshuar gjat vitit 2015

Kategorit Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2015	Buxheti i ndryshuar me Rishikim të Buxhetit-2015	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit 2015	Buxheti Perfundimtar 2015
<b>Paga dhe mëditje</b>	173,919	(-45,713)	(-4,714)	123,492
<b>Mallra dhe shërbime</b>	84,674	(-11,061)	(-30,330)	43,283
<b>Shërbime Komunale</b>	7,820	-	(-2,602)	5,218
<b>Total:</b>	<b>266,413</b>	<b>56,774</b>	<b>37,646</b>	<b>171,993</b>

## 18.1 Struktura e buxhetit për vitin 2015

- Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit fiskal në shumë prej 171,993.00 € si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre së: Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit fiskal në shumë prej 171,993.00 € si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre së :
- 71.80 % të fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe mëditje,
- 25.16% të fondeve është akorduar për shpenzime mallra dhe shërbime,
- 3.03% për shpenzimet komunale.



## 19. BUXHETI I SHPENZUAR PËR VITIN 2015

Pas aprovimit të buxhetit për vitin 2015, në përputhshmëri me planin operacional, është bërë menaxhimi i fondeve të akorduara për Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Buxheti është realizuar me korrektësi sipas zërave të shpenzimeve dhe me efektivitet duke treguar kujdes që fondet e miratuara të shpenzohen sipas planit në kohën e duhur dhe me një administrim ekonomik efektiv. Realizimi i buxhetit, përkatësisht shpenzimet e PZAP-it për vitin 2015 sipas kategorive ekonomike i shprehur edhe në përqindje duket si në vijim:

**Tabela Buxhetit dhe Shpenzimeve - 2015**

Kategorit Ekonomike	Buxheti fillestar i aprovuar 2015	Buxheti i ndryshuar në fund të vitit 2015	Buxheti i shpenzuar-2015	Përqindja (%)
<b>Paga dhe mëditje</b>	173,919	123,492	123,492	100%
<b>Mallra dhe shërbime</b>	84,674	43,283	41,442	95%
<b>Shërbime Komunale</b>	7,820	5,218	5,155	99%
<b>Total:</b>	<b>266,413</b>	<b>171,993</b>	<b>170,089</b>	<b>99%</b>

### a) Paga dhe mëditjet

Për vitin 2015 për Kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve janë aprovuar mjete në vlerë prej 173,919€. Siç është cekur më lartë me ligjin Nr. 05/L -046 Për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës, kemi pasur shkurtime buxhetore në kategorinë e pagave dhe mëditjeve në shumë prej 45,713€.

Andaj PZAP për ndryshimet që kanë ndodhur në kategorinë e pagave dhe mëditjeve ka paraqitur kursime 15,000 euro ashtu siq është kërkuar nga MF, mirëpo në fund të procesit të Rishikimit të Buxhetit për vitin 2015 MF ka marrë si bazë për shkurtime të buxhetit shpenzimin e muajit maj 2015.

Në Institucionin tonë ka qenë një dallim në mes planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit për Paga dhe Mëditje, për arsye së për gjyqtaret (anëtarët e PZAP-it) buxheti për paga dhe mëditje është planifikuar siç është caktuar me vendim të Qeveris ndërsa anëtarët e panelit të cilët janë gjyqtar të Gjykatave Themelore, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, pagën primare e marrin në gjykatat përkatëse prej nga vijnë ndërsa në PZAP marrin pagë sekondare, por në kemi qenë të obliguar që për anëtarët e PZAP-it të planifikojmë pagën e plotë ashtu siq e kanë të caktuar me vendim të Qeverisë ngase në ndërkohë ata (gjyqtaret) kanë të drejtë që të kërkojnë pagën në PZAP si pagë primare. Në vitin 2015 me Rishikim të Buxhetit është shkurtuar buxheti i PZAP-it në kategorinë për Paga dhe Mëditje ku është marrë për bazë paga sekondare për anëtarët e PZAP-it. Edhe për vitin 2016 kemi qenë të obliguar të bëjmë

planifikimin e buxhetit për Paga dhe Mëditje duke marre për baze, respektivisht duke llogaritur pagën sekondare për anëtarët e Panelit, ndërsa për zyrtarët tjerë të punësuar nuk ka pasur ndryshime në planifikimin e buxhetit për Paga dhe Mëditje.

Edhe në fund të vitit 2015 me Vendim të Qeveris numer 12/64 është bërë shkurtimi në shumë prej 4,714€ , kjo shumë ka mbetur pa u shpenzuar për arsye së ende së kemi bërë rekrutimin e Drejtorit të Departamentit Ligjore. Shpenzimi për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2015 ka qenë 123,492.31€ apo 100% të buxhetit të planifikuar.

#### në € Paga dhe meditje

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2015
<b>Paga dhe meditje</b>	<b>123,492</b>
<b>Pagat neto përmes listes së pagave</b>	103,025
<b>Tatimi i ndalur në të ardhura personale</b>	8,706
<b>Kontributi pensional i punëtorit</b>	5,881
<b>Kontributi pensional i punëdhënësit</b>	5,881

#### b) Mallra dhe shërbime

Te kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve Buxheti i aprovuar në fillim të vitit ka qenë 84,674€, ku me Rishikim të Buxhetit kemi pasur shkurtim Buxhetor 11,061€ dhe në fund të vitit 2015 me Vendim të Qeveris nr.09/65 janë bërë shkurtime buxhetore në shumë prej 30,330€, ku gjithsejtë gjatë vitit 2015 në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve kemi pasur shkurtime Buxhetore në shumë prej 41,391€.

Shpenzimi për kategorinë mallra dhe shërbime për vitin 2015 ka qenë 41,441.98€ apo buxheti është shpenzuar 95% duke e krahasuar me buxhetin që ka mbetur në fund të vitit. Këto shpenzime janë realizuar nëpërmjet:

- Modullit të aprovimeve dhe
- Modullit të blerjeve-prokurimit.

Me poshtë janë të prezantuara në formë tabelare shpenzimet e kategorisë në mallra dhe shërbime për vitin 2015.

#### në € Mallra dhe shërbime

Kategoritë ekonomike	Shpenzimet -2015
<b>Mallra dhe Shërbime</b>	<b>41,442</b>
<b>Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit</b>	19,222
<b>Shërbimet e Arsimit dhe trajnimit</b>	-
<b>Shërbimet tjera telefonike vala 900</b>	6,800

<b>Shërbimet kontraktuese tjera</b>	1,296
<b>Shërbimet postare</b>	15
<b>Furnizim me ushqim dhe pije – jo dreka zyrt.uji</b>	90
<b>Furnizimi për Zyre</b>	1,631
<b>Taks komunale për regjistrim të automjet.zyrtar</b>	20
<b>Karburant për vetura</b>	1,075
<b>Sigurimi i automjeteve</b>	884
<b>Regjistrimi i automjeteve</b>	152
<b>Mirëmbajtja, riparimi i automjeteve</b>	974
<b>Mirëmbajtja e ndërtesave</b>	2,580
<b>Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative</b>	2,492
<b>Shpenzimet për informim publik</b>	1,179
<b>Shpenzime - Vendimet e Gjykatave</b>	1,015
<b>Drekat zyrtare</b>	2,017

#### c) Shërbimet komunale

Në kategorinë e Shërbimeve Komunale Buxheti i aprovuar në fillim të vitit ka qenë 7,820€, në fund të vitit 2015 me Vendim të Qeveris nr.09/65 janë bërë shkurtime buxhetore në shumë prej 2,602 €.

Shpenzimi për kategorinë shërbimeve komunale për vitin 2015 ka qenë 5,154.73€. apo buxheti është shpenzuar 99%.

Me poshtë janë të prezantuara në formë tabelore shpenzimet e kategorisë së shërbimeve komunale për vitin 2015.


në € **Shërbime komunale**

<b>Kategoritë ekonomike</b>	<b>Shpenzimet -2015</b>
<b>Shërbime komunale</b>	<b>5,155</b>
<b>Shpenzimet e Rrymes</b>	4,267
<b>Shpenzimet e telefonis fikse</b>	887

## 20. PJESA PËRMBYLLËSE E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE

Në bazë të dhënave të SIMFK dhe databazës të Sekretariatit të PZAP-it mund të përfundojmë se për vitin 2015 Buxheti u shpenzua **170,089€**. Pjesë përmbyllëse e këtij raporti të shpenzimeve është paraqitja grafike e planifikimit dhe realizimit të Buxhetit për vitin 2015.

### Paraqitja grafike e buxhetit të planifikuar dhe shpenzuaratë PZAP-it për vitin 2015





## 21. TË HYRAT E PZAP-IT

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në bazë të nenit 120 paragrafi 1 pika c) të Ligjit Nr.03/L-256 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-073 mund të shqiptoj gjykatat ndaj një Subjekti Politik në rast se përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ligji ose rregullave të KQZ-së.

Gjatë vitit 2015 janë ndërmarr disa aktivitete ku fillimisht është bërë rishikimi i statusit aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga viti 2009 e deri me 2014 dhe gjetja e modalitetit për përmbimin e borxheve (për këtë çështje kemi kërkuar nga KQZ-ja të na njofton se cilat subjekte politike janë ende aktive e cilat janë pasive apo cilat nuk janë çregjistruar dhe cilat janë çregjistruar nga KQZ-ja). Pas marrjes së përgjigjes nga KQZ-ja dhe informacioneve të hollësishme lidhur me statusin aktual të subjekteve politike që nuk i kanë shlyer borxhet nga viti 2009 e deri me 2014, PZAP-i ka filluar procedurën e përmbimit të vendimeve lidhur me gjykatat e papaguara të subjekteve politike.

Me përmbuesin privat kemi biseduar dhe kemi dakorduar për përmbimin e vendimeve të PZAP-it lidhur me gjykatat e papaguara të subjekteve politike për periudhën e zgjedhjeve të vitit 2009 – 2014.

Fillimisht nga Zyra Ligjore janë përgatitur materialet e nevojshme për përmbim të vendimeve të PZAP-it për zgjedhjet e vitit 2009/10 dhe 2010/11 dhe dorëzimin e ketyre materialeve në Zyren e Përmbuesit Privat.

Për zgjedhjet e vitit 2009/10 të pa përmbuara janë 15 vendime të PZAP-it, ndërsa shuma e gjykatave është 19,000.00 €. Gjatë procesit të përmbimit kemi pasur një progres të vogël në përmbimin e disa vendimeve.

Subjekti politik, respektivisht kandidati i pavarur **Adem Haxhi Gashi** ka paguar në tërësi shumën e gjykatave prej 200€ sipas vendimit të PZAP-it Anr.97/2010. subjekti politik, respektivisht kandidati i pavarur **Ahmet Krasniqi**, është duke e paguar gjykatën në shumë prej 200€ sipas vendimit Anr.100/2010 me këste mujore nga 37€ në muaj. Deri me tani ai i ka paguar 113€. Nga shuma totale e borxheve të pa paguara prej 19,000€ për zgjedhjet e vitit 2009 kanë mbetur të pa paguara nga subjektet politike shuma e gjykatave prej 18,687€.

Në tabelën e më poshtme janë të paraqitura në mënyrë të detajuar borxhet e SP-2009/10.

### Gjodat e shqiptuara dhe të pa paguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2009/10

Nr.	Nr. i vendimitte PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobësnë euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
1	Anr.79/2010	DRK	1,500	0	1,500
2	Anr.83/2010	PLK	4,800	0	4,800
3	Anr.81/2010	RRKPZ	4,800	0	4,800
4	Anr.85/2010	PRSH	1,500	0	1,500
5	Anr.86/2010	GIO	500	0	500
6	Anr.88/2010	SDP	3,200	0	3,200
7	Anr.90/2010	JSZH	500	0	500
8	Anr.91/2010	ZBB	500	0	500
9	Anr.92/2010	ZEG	500	0	500
10	Anr.93/2010	KP. Bajram Islami	200	0	200
11	Anr.95/2010	KP. Mexhit Foniqi	200	0	200
12	Anr.98/2010	KP. Naim Mustafa	200	0	200
13	Anr.99/2010	KP. Hasan Bilalli	200	0	200
14	Anr.97/2010	KP. Adem Haxhi Gashi	200	200	0
15	Anr.100/2010	KP. Ahmet Krasniqi	200	113	88
	<b>Total:</b>		<b>19,000</b>	<b>313</b>	<b>18,687</b>

Për zgjedhjet e vitit 2010/11 të pa përmbuaruara janë 3 vendime të PZAP-it ndërsa shuma e gjobave është 5,550.00 €;

### Gjodat e pa paguara të subjekteve politike për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare 2010/11

Nr.	Nr. I vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjektipolitik	Shuma e gjobësnë euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
3	Anr.426/2010	LDD	2,500	0.00	2,500
5	Anr.389/2010	FER	1,500	0.00	1,500
6	Anr.434/2010	FER	1,550	0.00	1,550
	<b>Total:</b>		<b>5,550.00</b>	<b>-</b>	<b>5,550.00</b>

**Gjithsejtë: të papërmbaruara janë 18 vendime; ndërsa lartësia e gjobave është 24,237€.**

Per zgjedhjet lokale të mbajtura në vitin 2013 kemi pas borxhe të subjekteve politike të pa arkëtuara në shume prej 1,150€

Gjatë vitit 2015, këtyre katër subjekteve politike ju kemi dërguar paralajmërim për pagesën e gjobave të papaguara. Prej katër subjekteve politike të paralajmëruara për pagesën e gjobave të papaguara, dy prej tyre i kane paguar shumen prej 500.00 euro ndërsa dy prej tyre nuk i kanë paguar ende.

**Nga gjobat e shqiptuara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur në Zgjedhjet Lokale 2013 kanë mbetur borxhe në shumë prej 650€.**

Në tabelën e mëposhtme janë të paraqitura në mënyrë të detajuar borxhet e SP-2013.

**Gjopa të shqiptuara dhe të papaguara të subjekteve politike dhe kandidatëve të pavarur për zgjedhjet lokale 2013**

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
2	Anr. 300/2013	G.I Narodna Incijativa	400	-	400
3	Anr.320/2013	Nisma Qytetare për Prizrenin (NQP)	250	-	250
	<b>Total:</b>		<b>650</b>	<b>-</b>	<b>650</b>

Për zgjedhjet e vitit 2013, por që denimet janë shqiptuar në vitin 2014 kanë mbetur të papaguara shuma e gjobave prej 4,900.00 €.

Ndërsa për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të mbajtura me 8 qershor-2014, shuma e gjobave të papaguara është edhe 250€.

**Pra gjithsejtë borxhe të papaguara për zgjedhje në vitin 2014 kanë mbetur edhe 5,150€.**

**Në tabelën e më poshtme janë paraqitur të gjitha gjobat e papaguara për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare të Republikës së Kosovës të mbajtura me 8 qershor-2014.**

Nr.	Nr. i vendimit të PZAP ish KZAP-it	Subjekti politik	Shuma e gjobës në euro	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit
2	Anr.122/2014	Grupi Tradicional Shqipëtar (GTSH)	250	-	250
3	Anr.26/2014	Hajrullah Shehu –Kandidati	200	-	200

		Pavarur			
<b>5</b>	Anr.27/2014	Isuf Musliu- Kandidati Pavarur	200	-	200
<b>6</b>	Anr.31/2014	GI. Nove Snage	1,500	-	1,500
<b>7</b>	Anr.33/2014	KTB	3,000	-	3,000
	<b>Total:</b>		<b>5,150</b>	<b>-</b>	<b>5,150</b>

Gjithsej borxhe të papaguara për të gjitha proceset zgjedhore prej vitit 2009 - 2014 janë 30,037€.

Gjatë vitit 2015 në llogarinë e të hyrave të PZAP-it ka pasur realizim të hyrave në shumë prej 71,855€, ku ky fond i mbledhur transferohet dhe mbahet në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

## **22. BASHKËPUNIMI I PZAP-it ME ZYREN E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM – ZAP**

Me ligjin 03/L-075 " Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit të Kosovës" i është dhënë e drejta ekskluzive që të auditoi të gjitha Institucionet e sektorit publik të cilat janë përfituese dhe shfrytëzuese të parasë publike nëpërmjet të buxhetit të konsoliduar të Kosovës.

Ky kontroll është definuar si kontroll i jashtëm, funksioni i të cilit është të auditoi këto Institucione nëse aktivitetet e këtyre janë në pajtueshmëri me objektivat e përcaktuara nga vetë institucioni dhe me ligjet dhe rregulloret në fuqi duke verifikuar shkallen e zbatimit të objektivave të institucionit (matjen e performances), pajtueshmërisë me to dhe me ligjet në fuqi.

Në harmoni me këto të cilat u ceken më lartë, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, nëpërmjet Raportit të Auditimit nr. 24.2.-2015 me numër të regjistrimit 333 të datës 17.06.2015 ka informuar kryetarin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësues - PZAP-it lidhur me përfundimin e aktivitetit auditues për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën 01 janar – 31 dhjetor 2014.

Në bazë të vlerësimeve të auditorit të përgjithshëm është dhënë edhe opinion i tij për pasqyrat financiare i cili është përkufizuar si në vijim:

**Sipas opinionit tone pasqyrat financiare në të gjitha aspektet material prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë.**

### **FOKUSIMI I AUDITIMIT TË AUDITORIT GJENERAL**

Aktivitetet e auditimit të auditorit gjeneral janë të fokusuar kryesisht në auditimin e :

- **Pasqyrave financiare vjetore që përfundojnë me 31.12.2014;**

- Menaxhimin financiar, kontrollin e brendshëm (duke përfshirë menaxhimin, planifikimin dhe ekzekutimin e buxhetit) dhe;
- Menaxhimin e pasurisë;
- Menaxhimin e personelit dhe
- Sistemin e auditimit të brendshëm.

Në bazë të fokusimit të auditimit edhe rekomandimet janë dhënë në ato fusha. Këto rekomandime kanë të bëjnë me:

## 23. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit rekomandimet e auditorit gjeneral janë dhënë lidhur me:

- **PZAP-i, duhet të siguroj që planifikimi i buxhetit të bëhet duke u bazuar në nevojat reale të PZAP-së për kryerjen e aktiviteteve dhe kontrollit gjatë tërë vitit.**

### PLANI, DINAMIKA, PËRGJEGJËSIT DHE AKTIVITETET E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT GJENERAL

NR	PËRSHKRIMI I REKOMANDIMIT	PËRGJEGJËS PËR ZBATIM	AKTIVITETET QË DUHET NËRMARRË	AFATI I ZBATIMIT
1	Kryesuesi i Sekretariatit të PZAP-it duhet që të siguroj që të gjitha format e kërkuara me rregullat e thesarit të plotësohet në mënyrë të qarte dhe kronologjike	ZKA dhe ZKF	PZAP-i zotohet që rekomandimin e ZAP-it të zbatoj, respektivisht furnizim me mallra dhe pranimi i faturës do të bëhet pas urdhërbljes	Gjatë vitit 2015
2.	Kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it duhet që të siguroj që gjatë periudhave të caktuara si rezultat i zgjedhjeve të shtoj masat e kontrollit të brendshëm në mënyrë që të gjitha kompensimet të bëhen sipas legjislacionit dhe vendimeve përkatëse.	ZKA dhe ZKF	Kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it zotohet që rekomandimin e ZAP-it të zbatoj, respektivisht kompensimet dhe shtesat gjatë proceseve zgjedhore do të paguhen sipas legjislacionit dhe vendimeve përkatëse.	Gjatë vitit 2015
3	Kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it duhet që të siguroj që kontrollet e vendosura lidhur me mbajtjen e rregullave dhe evidencave për përdorimin dhe shfrytëzimin e automjeteve të funksionojnë në mënyrë të efektive	ZKA dhe ZKF	Kryesuesi i sekretariatit të PZAP-it gjatë vitit 2014 ka filluar që të zbatoj me përpikëri këtë rekomandim dhe i cili do të vazhdon të zbatohet.	Gjatë vitit 2015